Dolën për gjueti, policia ua sekuestroi armët në Prizren

14 janar 2024, 21:39

Shpërndaje në

Policia e Kosovës të dielën ka shoqëruar pesë persona në Stacionin Policor në Prizren, si dhe ka konfiskuar pesë pushkë gjysmë-automatike, të cilat dyshohen se do të përdoreshin për gjueti.

Zëdhënësi i Policisë për rajonin e Prizrenit, Vesel Gashi, ka thënë se rasti ka ndodhur sot rreth orës 14:05.

"Policia ka marrë informacion se mbi fshatin Jeshkovë, Prizren, pranë disa shtëpive malore, dyshohet se janë disa persona të armatosur, si duket kanë dalë për gjueti. Patrullat policore janë nisur në atë drejtim dhe në rrugën malore mbi fshat kanë hasur dhe kanë ndaluar një automjet me tre persona. Gjatë kontrollit të automjetit u gjetën tri armë të gjata, pushkë gjysmë automatike dhe rreth 30 fishekë", ka thënë Gashi.

Të dyshuarit janë shoqëruar në Stacionin Policor në Prizren ku janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës.

"Armët e gjetura ishin pa leje nga organet kompetente dhe me urdhër të prokurorit janë sekuestruar, ndërsa të dyshuarit janë liruar me procedurë të rregullt", ka shtuar Gashi.

Ai ka bërë po ashtu të ditur se bazuar në informatën e njëjtë, patrullat policore kanë ndaluar edhe dy vetura në rrugën malore Lubigevë - Jeshkovë, ku në dy automjete janë gjetur edhe dy armë të tjera.

Dy të dyshuarit pas intervistimit në prani të avokatëve mbrojtës janë liruar me procedurë të rregullt, ndërsa armët, të cilat ishin pa leje, janë sekuestruar. /KSP

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Taboola Feed

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Mbani në kontroll Psoriasis dhe Egzemën në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Disa keshilla ne lidhje me Psoriasis
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

These Are the New Trends in Bathroom Remodeling - You Will...
Bathroom Remodeling | Sponsored

Most Computer Owners Don't Know This. Do It Today!
This Could Be the Most Important Tip You Read This Year
Outbyte Driver Updater | Sponsored
Click Here

Pllakat e reja të murit prej gome nuk kërkojnë instalim (Kërko këtu për pllaka)
Pllaka muri gome | Kërko reklama | Sponsored

A Homeless Man Came To The Wedding. Then He Took The...
NFTscores.io | Sponsored

Cyprus investments might surprise you
Investments Cyprus | Search Ads | Sponsored

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave
Blog | Sponsored
Lexo më shumë



Mom Receives Help from a Stranger Who Fixes Her Car, Then Hears His...
TripOnMag.com | Sponsored

Cat Leads Her Pack Of Husky Dogs
BestFamilyMag.com | Sponsored

"U nis në drejtim të Serbisë dhe u zhduk", gjakovarja raporton vëllain e zhdukur nga nëntori
Kohanet

Eksperti gjerman: Shitja e raketave amerikane për Kosovën, sinjal i ndryshimit të raporteve me Serbinë
Kohanet

Rahovecianit i vidhet kamioni nga persona të panjohur

Sulmohet seksualisht një grua në Kaçanik

Arrestohet një person në Fushë-Kosovë, dyshohet se shantazhoi shtetasen austriake

Vrasje në tentativë në Podujevë

Kapen pesë pushkë gjysmautomatike në Prizren

Gjobitet shoferi i dehur në Ferizaj

U trenës nga tërmeti, 18-vjeçari në Lushnjë humb jetën pasi u rrëzua nga shkallët

TË TJERA

Sekuestrohet sasi e konsiderueshme e drogës në Prishtinë, arrestohen katër persona

Kërcënoi se do t'i djegë zyrat e një kompanie, arrestohet i dyshuari në Vushtrri

Një person gjendet i vdekur në Dragash

Katër nga 15 të lënduarit nga bombola e gazit në Mitrovicë në gjendje më të rëndë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardëso mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internetit a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e kësaj të drejtave do të ndiqafapohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!